



Funded by
the European Union



Reporting
Diversity
Network

LICEULICE

fotografi: Marija Janković

LICEULICE

UDHËZIME PËR RAPORTIMIN ETIK MBI PASTREHËSINË DHE VARFËRINË

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian në kuadër të programit të Rrjetit të Raportimit të Diversitetit. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e organizatës LICEULICE dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian apo të programit të Rrjetit të Raportimit të Diversitetit.

Botuesi:

Liceulice

Për botuesin:

Millosav Marinoviq

Përgatiti:

Dunja Karanoviq

Faqosja dhe dizajni:

Tamara Kalçiq

Lektura i korrektura:

Sandra Gjuriq Millinov

Fotografitë:

Marija Jankoviq,

Gavrilo Andriq,

Predrag Trokiciq

Figurat:

Tamara Kalçiq,

Andreja Lepir

**Bashkëpunëtoret në
përgatitjen e publikimit:**

Katarina Bogdanoviq (ADRA),

Milica Jociq (ADRA),

Gorica Nikolin (A11),

Ema Stepanoviq (A11),

Iva Petroviciq (Liceulice)

Beograd, 2026.



**PSE ËSHTË E
RËNDËSISHME MËNYRA
SE SI RAPORTOJMË
MBI PASTREHËSINË DHE
VARFËRINË?**

**PSE ËSHTË
RËNDËSISHME
SE SI RAPORTOJMË
MBI PASTREHËSINË DHE
VARFËRINË?**

Pastrehësia, varfëria dhe përjashtimi social janë probleme strukturore që kërkojnë zgjidhje sistematike dhe përgjegjësi shoqërore. Në raportimin mediatik për këto tema, e sidomos në fotografi dhe paraqitje të tjera vizuale, më së shpeshti hasim një pikëpamje të shtrembëruar – ku jeta në rrugë paraqitet si pasojë e një tragjedie personale, zgjedhjeve të këqija ose rrethanave fatkeqe. Pastrehësia dhe varfëria nuk janë vetëm probleme individuale, por fenomene të ndërlikuara shoqërore që lindin në ndërthurjen e faktorëve ekonomikë, institucionalë dhe socialë.

Mënyra se si ne, si medie, raportojmë mbi pastrehësinë dhe varfërinë ndikon ndjeshëm në mënyrën si shoqëria i kupton këto dukuri dhe si sillet ndaj tyre. Raportimi i papërgjegjshëm mund të kontribuojë për forcimin e stereotipave dhe paragjytimeve, për dehumanizimin e njerëzve që jetojnë në varfëri ose gjenden në situatë të pastrehësisë, si edhe zhvendosjen e përgjegjësisë nga sistemi tek individët. Përveç faktit se raportimi i paplotë, stereotip dhe/ose sensacional për këto tema mund të çojë në uljen e empatisë dhe të solidaritetit të lexuesit dhe shikuesit tanë, ai e vështirëson kuptimin e shkaqeve të problemeve strukturore, që prekin të gjithë qytetarët dhe qytetaret.

Përkundrazi, raportimi i përgjegjshëm dhe etik kontribuon për informimin e publikut, uljen e stigmës dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e politikave publike më të drejta – politikat që shërbejnë t'i mbrojnë të gjithë qytetarët dhe qytetaret, e jo vetëm ata që jetojnë në varfëri të skajshme ose në margjinat e shoqërisë.

Udhëzime për raportimin etik mbi pastrehësinë dhe varfërinë që keni përpara përmbledhin përvojën që revista “Liceulice” ka ndërtuar nga viti 2010 në raportimin mbi varfërinë, diskriminimin sistematik dhe pabarazitë në strehim dhe ekonomi me të cilat përballen edhe bashkëqytetarët tanë më të cenueshëm, si edhe në ofrimin e mbështetjes së drejtpërdrejtë për pavarësimin ekonomik të tyre. Parimet që këtu promovojmë janë zhvilluar në bazë të punës sonë redaksionale, punës së drejtpërdrejtë me përfituesit dhe përfitueset, si edhe të bashkëpunimit me organizatat partnere të Rrjetit për Luftën kundër Pastrehësisë¹. Këto organizata ofrojnë në terren shërbime si mbështetje juridike falas, mbështetje psikologjike, kujdes shëndetësor, vakte të ngrohta dhe ndërmjetësim në komunikim me institucionet e mbrojtjes sociale – pra të gjitha ato shërbime që garantojnë një jetë me dinjitet dhe duhet të sigurohen nga shteti.

Këto udhëzime janë hartuar për të gjitha redaksitë, shtëpitë mediatike, gazetarët dhe gazetarët, ekipet redaktuese, fotoreporterët dhe fotoreporteret, që, në pajtim me Kodin e Gazetarëve dhe të Gazetareve të Serbisë, dëshirojnë të raportojnë në mënyrë të saktë, të paanshme dhe të plotë mbi problemet me pastrehësinë dhe varfërinë në përputhje me interesin publik dhe parimet etike të profesionit të tyre.

1 Rrjeti për Luftën kundër Pastrehësisë përbëhet nga organizatat themeluese të saj: organizata A11 – Nisma për të Drejtat Ekonomike dhe Sociale, ADRA, KlikAktiv, Kuzhina e Solidaritetit Novi Sadi, Liceulice, Qendra Rinore CK13, PIN – Rrjeti i Inovacioneve Psikosociale dhe Caritas Serbi, si edhe organizatat Patrija, Info Park, Organizata Humanitare Ekumenike (OHE) dhe Grupi Budi 1.



**PASTREHËSIA DHE
VARFËRIA JANË FENOMENE
TË NDËRLIKUARA
SHOQËRORE**

**PASTREH
VARFËRI
TË NDËR
SHOQËRO**

Pastrehësia nuk e nënkupton vetëm jetesën në rrugë. Ajo përfshin edhe personat që jetojnë në kushte të përkohshme, të pasigurta dhe të papërshtatshme të strehimit, si edhe ata që varen nga ndihma e të tjerëve për strehim. Varfëria dhe pastrehësia janë pasojë e faktorëve sistematikë të ndërlidhur, ndër të cilët janë politikat e papërshtatshme të strehimit, format e pasigurta dhe të përkohshme të punës, qasja e kufizuar dhe efikasiteti i pamjaftueshëm i sistemit të mbrojtjes sociale, përvojat dhunës, diskriminimet, përjashtimi institucional dhe mungesa e dukshmërisë në shoqëri, si edhe gjendjet shëndetësore që vështirësojnë qasjen në tregun e punës.

Koncepti i pastrehësisë në legjislacionin vendas nuk është i përcaktuar mjaftueshëm qartë, e kjo jë e vështirëson evidentimin e numrit të personave që ndodhen në situatë të pastrehësisë dhe pengon një përgjigje përkatëse dhe gjithëpërfshirëse të shtetit ndaj këtij problemi shoqëror. Në kontekstin e regjistrimit të popullsisë përdoren termat **pastrehësi parësore dhe pastrehësi dytësore**. Pastrehësia parësore nënkupton formën e dukshme të pastrehësisë (jetesën pa strehë, fjetjen në rrugë ose në hapësira publike), kurse pastrehësia dytësore përfshin strehimin e përkohshëm, qëndrimin në qendra për të pastrehët, strehimore ose në hapësira të braktisura. Tipologjia Evropiane e Pastrehësisë dhe Përjashtimit nga Strehimi, që është zhvilluar nga Federata Evropiane FEANTSA², e përkufizon **pastrehësinë** si mungesë të strehës, domethënë mungesë të një shtëpie ose banese. Ndërkaq, me termin **përjashtim nga strehimi** nënkuptohen format e strehimit të pasigurt (qëndrimi te të njohurit, banimi i paligjshëm, jetesa nën kërcënimin e largimit me forcë nga banesa) dhe strehimi i papërshtatshëm (jetesa në kushte johigjienike, në ndërtime jokonvencionale, fjetja në automjete ose në ambiente me një numër shumë të madh të banorëve).

Është e rëndësishme të kuptojmë se **personat në situatë të pastrehësisë nuk përbëjnë një grup homogjen** dhe se përvojat e tyre mund të jenë shumë të ndryshme; ajo që i bashkon është mungesa e mbështetjes institucionale. Ndër kategoritë e popullsisë që janë veçanërisht të rrezikuara janë personat pa dokumente personale, personat e zhvendosur brenda vendit, apatridët, romët dhe romet, si dhe pjesëtarët e pakicave të tjera kombëtare, anëtarët dhe anëtarët e komunitetit LGBT+, personat me çrregullime të shëndetit mendor, personat me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje, veteranët e luftës, personat me probleme të varësisë, refugjatët, mërgimtarët dhe kërkuesit e azilit, fëmijët dhe të rinjtë që dalin nga sistemi i mbrojtjes sociale, personat që lirohen nga institucionet korrektuese, si dhe grupe të tjera.

Kur bëhet fjalë për varfërinë, të dhënat e Entit Shtetëror për Statistikë³ tregojnë se në Serbi shkalla e rrezikut nga varfëria në vitin 2025 ishte 19,6%, ndërsa për qytetarët mbi moshën 65-vjeçare ishte 25,8%. Ndërkohë, shkalla e rrezikut nga varfëria ose përjashtimi social ishte 23,2%. Kjo do të thotë se, kur raportojmë për këtë problem, ne raportojmë për një realitet me të cilin përballlet midis një të pestës dhe një të katërtës së popullsisë së Serbisë.

2 Shih *O beskućništvu u Srbiji iz ugla Mreže za borbu protiv beskućništva*, ADRA, 2025. [Për pastrehësinë në Serbi nga pikëpamja e Rrjetit për Luftën kundër Pastrehësisë, ADRA, 2025.]

3 Shih *Siromaštvo i socijalna nejednakost*, 2025, RZZS, 2026. [Varfëria dhe pabarazia sociale, 2025, ESHS, 2026]

Kur raportojmë për temat e pastrehësisë, varfërisë dhe përjashtimit social, gjëja më e rëndësishme është që këto dukuri të mos paraqiten si pasojë e vendimeve personale, gabimeve, rrethanave të jashtëzakonshme jetësore apo të dështimeve individuale, por si rezultat i mangësive më të gjera shoqërore dhe sistematike. E drejta për strehim dhe për një jetë me dinjitet garantohet nga Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore, Kushtetuta e Republikës së Serbisë, Karta Sociale Evropiane, si dhe nga një sërë konventash ndërkombëtare që mbrojnë nga diskriminimi dhe që janë të ratifikuara nga Serbia (Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial etj.). Në këtë kuptim, mediet duhet të raportojnë për shkeljet e të drejtave themelore të njeriut kur trajtojnë temat e pastrehësisë dhe varfërisë dhe të vënë në pah mangësitë e sistemit që e rezikojnë mbarë popullsinë, e jo vetëm individë të veçantë.



*fotografi: Predrag Trokicij




**MË TË
NË**


**GABIMET MË TË
SHPESHTA NË
RAPORTIM**

**GABIMET M
SHPESHTA
RAPORTIM**

Në raportimin mediatik mbi pastrehësinë dhe varfërinë shpesh hasen gabimet e mëposhtme:

- paraqitja sensacionale e varfërisë dhe pastrehësisë dhe shfrytëzimi i vuajtjes përmes titujve “*clickbait*” dhe frazave stereotipe (“ferri në rrugë”, “kërkon ndihmë me dëshpërim”, “njeri i pastrehë për të cilin qan e gjithë Serbia”);
- romantizimi i kushteve të vështira të jetesës (“jeton në mënyrë modeste, por është i lumtur”)
- zhvendosja e përgjegjësisë te individit dhe përqendrimi te historitë personale (“u bë njeri i pastrehë për shkak të alkoolit”, “ra në kthetrat e alkoolit”, “ishte drejtor, por mbaroi si njeri i pastrehë”, “vdiq në varfëri”);
- lidhja e pastrehësisë me veprimtari kriminale dhe përhapja e panikut (“nëna që mashtroi Serbinë”; “mashtroesja që lyp në rrugë”);
- përdorimi i materialeve vizuale dehumanizuese (fotografimi dhe xhirimi pa pëlqim, paraqitja e personave në situata të rrezikshme, poshtëruese ose intime);
- zbulimi i të dhënave personale dhe shpërndarja e detajeve pa lejen e bashkëbiseduesit ose bashkëbisedueses;
- raportimi sipërfaqësor pa vënë në dukje problemet strukturore, kuadrat ligjorë dhe përgjegjësinë e institucioneve;
- stereotipizimi dhe reduktimi i përvojës së varfërisë dhe pastrehësisë në një përvojë homogjene.





TIKE
IT

**PARIMET
THEMELORE ETIKE
TË RAPORTIMIT**

**PARIME
THEMELORE
TË RAPORTIMIT**

Mediet kanë një rol të rëndësishëm në formësimin e diskursit publik mbi pastrehësinë dhe varfërinë. Përmes raportimit të përgjegjshëm mund të kontribuojmë për uljen e stigmës dhe të paragjyqimeve, kuptimin më të mirë të shkaqeve shoqërore, nxitjen e solidaritetit dhe të përgjegjësisë shoqërore të publiku dhe komuniteti më i gjerë, si edhe përmirësimin e politikave publike.

Raportimi etik mbi pastrehësinë dhe varfërinë bazohet në parimet e mëposhtme:

Dinjiteti dhe respektimi

Personat për të cilët raportohet duhet të paraqiten si individë të plotë, dhe jo të reduktohen vetëm në situatën e tyre aktuale jetësore ose në rrethanat që kanë çuar deri tek ajo. Bashkëbiseduesit dhe bashkëbisedueset që e ndajnë përvojën personale të pastrehësisë ose varfërisë me publikun tonë nuk duhet të paraqiten si persona të pafuqishëm dhe “tragjikë” që ngjallin dhembshuri, as situata e tyre nuk duhet të romantizohet.

Parimi i mosdëmtimit

Raportimi nuk duhet ta rrezikojë sigurinë, privatësinë ose gjendjen psikologjike të bashkëbiseduesit dhe bashkëbisedueses. Informatat personale, siç janë të dhënat shëndetësore, problemet ligjore, përdorimi i substancave të paligjshme, vendbanimi, orientimi seksual, posedimi dhe mungesa e shtetësisë ose dokumenteve personale që mund ta vendosin personin në një situatë të pafavorshme në lidhje me rrezikun e dhunës, humbja e përfitimeve sociale, largimi me forcë nga banesa, gjobat, ndalimi nga autoritetet etj. nuk duhet të zbulohen në raportime mediatike. Intervista, reportazhi ose biseda joformale me bashkëbiseduesin ose bashkëbiseduesen në situatë të pastrehësisë duhet të realizohen vetëm me pëlqimin paraprak dhe në moment dhe në rrethana që janë të përshtatshme për atë person. Nuk duhet të zhvillohen kurrë në gjendje stresi të shtuar, frike, lodhjeje, ankthi ose nën presion.

Privatësia dhe pëlqimi i informuar

Bashkëbiseduesit duhet të informohen për qëllimin e publikimit, kontekstin në të cilin do të paraqiten historitë e tyre dhe pasojat e mundshme të zbulimit të informatave personale. Para citimit ose publikimit të informatave personale, personit me të cilin kemi biseduar duhet t’ia ofrojmë tekstin për miratim, ose t’i paraqitet paraprakisht regjistrimi audio/video që planifikojmë ta publikojmë.

Saktësia dhe konteksti

Informatat që ndajmë me publikun duhet të jenë të verifikuara dhe të paraqitura në një kuadër më të gjerë shoqëror dhe ekonomik. Kjo arrihet përmes referimit të kuadri ligjor relevant, shqyrtimit të dhënave të ofruara nga institucionet

shtetërore dhe organizatat e shoqërisë civile, por edhe përmes përzgjedhjes së bashkëbiseduesve dhe bashkëbisedueseve. Është e dëshirueshme të kemi më shumë se një bashkëbisedues ose bashkëbiseduese në tekstet dhe shtojcat mediatike, dhe është veçanërisht e rëndësishme të përfshihen organizata kompetente, punëtorë dhe punëtore në terren, si dhe aktivistë dhe aktiviste që merren çdo ditë me tema për të cilat raportojmë, si edhe vetë personat me përvojë të pastrehësisë dhe varfërie, sa herë që kjo është e mundur.

Shmangia e stigmatizimit

Në raportim nuk duhet të përdoren gjuha dhe narrativët që nxisin stereotipa, paragjykime ose diskriminim. Përveç termit 'i pastrehë', i cili situatën e pastrehësisë paraqet si identitet dhe e stigmatizon personin me të cilin ose për të cilin flasim, duhet të shmangen edhe shprehjet që kontribuojnë për diskriminim mbi bazën e gjinisë, kombësisë, racës, fesë, orientimit seksual, moshës ose gjendjes shëndetësore. Personat në situatë të pastrehësisë dhe varfërie të skajshme rrallë janë të pranishëm në medie, prandaj është veçanërisht e rëndësishme që raportimet mediatike të mos nxisin stereotipa që shkaktojnë frikë ose panik te publiku (siç janë narrativët e shpeshta si personat që lypin janë agresivë, mashtrues, të dhënë pas vjedhjes etj.).

Theksimi i shkaqeve sistematike

Raportimi duhet të ndriçojë faktorët strukturorë që kontribuojnë për varfëri dhe pastrehësi, në vend që t'i paraqesë ata si probleme individuale. Përvojat e një bashkëbiseduesi apo të një bashkëbisedueseje të veçantë mund të shërbejnë si shembull, por një raportim mediatik i plotë duhet të theksojë problemet që mund të prekin tërë shoqërinë, pjesën e qytetarëve që gjenden në rrezik të veçantë, si edhe zgjidhjet e mundshme sistematike.





International
Partnership for
Assistance

fotografi: Gavrillo Andriq



**UDHËZIME PËR
RAPORTIMIN**

**UDHËZIME PËR
RAPORTIMIN**

**UDHËZIME PËR
RAPORTIMIN**

Gjuha dhe terminologjia

Në raportim është e nevojshme të përdoret një gjuhë e qartë, neutrale dhe e saktë që nuk stigmatizon. Rekomandohet të përdoret gjuha që e vendos personin në situatën në të cilën ndodhet (angl. *person-first language*), pra termi ‘personi në situatë të pastrehësisë’, e jo i pastrehë ose e pastrehë, lypës, vagabond etj.

Kur bëhet fjalë për citimet, personi me të cilin bisedojmë mund të flasë për veten në mënyrën që i përshtatet atij ose asaj, dhe këtë zgjedhje duhet ta respektojmë; duhen shmangur citime që nxisin stereotipa dhe diskriminim.

Zgjedhja e temës

Pastrehësia dhe varfëria janë probleme të ndërlikuara që përfshijnë një gamë të gjerë të përvojave, me të cilat mediet merren rrallë. Kur raportohet për to, më së shpeshti bëhet fjalë për pastrehësinë parësore dhe raste aktuale për bisedë, siç është Dita Ndërkombëtare e të Pastrehëve (më 10 tetor), periudhat e vitit kur është vapë ose është shumë ftohtë, apo situata urgjente si mbyllja e strehimoreve ose ndryshimet ligjore.

Është e rëndësishme të raportohet për këto tema gjatë gjithë vitit, duke marrë parasysh pikëpamje të ndryshme – pastrehësia dhe varfëria prekin në mënyra të ndryshme të moshuarit, gratë, fëmijët dhe të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, personat e dhunuar, grupet e marginalizuara, personat pa dokumente personale, mërgimtarët dhe personat pa shtetësi, si dhe njerëzit që jetojnë në zona rurale. Sa herë që është e mundur, duhet të raportohet për format “e padukshme” të pastrehësisë – për përjashtimin nga strehimi dhe përvojat e personave që përballen me forma të shumëfishta diskriminimi.

Zgjedhja e bashkëbiseduesit/es

Në raportim është e rëndësishme të përfshihen personat me përvojë të pastrehësisë dhe varfërisë, specialistët dhe specialistet nga fushat përkatëse dhe organizatat që ofrojnë mbështetje dhe punojnë me grupet e marginalizuara. Është e nevojshme të shmanget qasja në të cilën flitet për njerëzit pa pjesëmarrjen dhe pikëpamjen e tyre.

Në zgjedhjen e bashkëbiseduesve ose bashkëbisedueseve, organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertët e ekspertet që punojnë me personat në situatë të pastrehësisë ose varfërisë së skajshme përfaqësojnë një mbështetje të rëndësishme. Përveç se mund të ofrojnë një kontekst më të gjerë dhe të ndajnë përvoja nga puna me përfituesit dhe institucionet, ata mund të shërbejnë edhe si ndërmjetës në komunikimin me bashkëbiseduesit dhe bashkëbisedueset dhe të ndihmojnë që personi me të cilin bisedojmë të ndihet më rehat, të kuptojë qëllimin e intervistës dhe të drejtat e tij ose të saj kur bëhet fjalë për pëlqimin e informuar dhe miratimin.

Punëtorët socialë, aktivistët e Rrjetit për Luftën kundër Pastrehësisë, psikologët dhe punëtorët në terren janë gjithashtu ata që mund të vlerësojnë më mirë nëse një bashkëbisedues ose një bashkëbiseduese është në pozitë të flasë me mediet pa rrezikuar sigurinë e vet, privatësinë ose shëndetin mendor. Është e rëndësishme që ne, si gazetarë dhe redaktorë, t'u mundësojmë atyre kohë të mjaftueshme për të dhënë deklaratat, për miratimin dhe/ose për kontaktimin e përfituesve dhe përfitueseve. Afatet në medie janë shpesh të shkurtra, por nuk mund të presim që dikush t'u përgjigjet pyetjeve tona ose ta përgatisë bashkëbiseduesin për intervistë për më pak se 24 orë. Raportimi etik kërkon planifikim dhe përgatitje të përshtatshme.

Intervistimi i bashkëbiseduesit/es

Para vetë intervistës është e nevojshme të shpjegohet qëllimi i intervistës, ta marrim pëlqimin e informuar dhe të njoftohet bashkëbiseduesi/ja me pasojat e mundshme të publikimit. Kjo shpesh nënkupton që të njihemi me ta (me ose pa ndërmjetës) para se të fillojmë të regjistrojmë historinë e tyre.

Gjatë intervistës është e rëndësishme të respektohet e drejta e bashkëbiseduesit/es për të refuzuar t'u përgjigjet pyetjeve që i shkaktojnë parehati dhe për të tërhequr pëlqimin nëse vendos ta bëjë këtë. Bisedën fillojmë me respekt dhe empati, duke shmangur presionin dhe këmbënguljen. Ka arsye të ndryshme pse dikush pranon ta ndajë historinë e vet. Ne duhet të kujdesemi që ky person me të cilin bisedojmë të mos ndihet sikur ka detyrimin të ndajë të dhëna personale “për të na bërë nder”, sepse ne i bëjmë nder atij ose asaj, apo “për të marrë diçka në këmbim”. Nga ana tjetër, është e nevojshme të kuptohet se këta persona që jetojnë në varfëri të skajshme ose që nuk e kanë të zgjidhur çështjen e strehimit, po ndajnë kohë për të folur me mediet kur mund të vizitonin një kuzhinë publike ose të kërkojnë strehim për këtë ditë. Prandaj, është krejtësisht e arsyeshme që duhet t'i kompensojmë për kohën e tyre duke pirë kafe së bashku ose duke ndarë një vakt.

Nëse personi me të cilin bisedojmë e dëshiron këtë, duhet t'i mundësohet që gjatë intervistës të marrë pjesë edhe ndonjë person tek i cili ai ose ajo ka besim – ndërmjetësi, shoku ose shoqja, punëtori ose punëtorja sociale ose dikush tjetër. Personat në situatë të pastrehësisë shpesh kanë përvoja traumatike, përvoja shfrytëzimi ose dhune, dhe nuk na kanë borxh besim vetëm sepse ne jemi punëtorët dhe punëtoret të medias dhe kemi qëllime të mira.

Pas publikimit të intervistës është e dëshirueshme të mbetemi në kontakt me bashkëbiseduesit, t'u sigurojmë një kopje të medias në të cilën është publikuar intervista ose t'ua tregojmë artikullin ku ata shfaqen, si edhe të kujdesemi për kontekstin ku paraqitet historia e tyre.

Intervista ose pjesët e saj nuk duhet të nxirren jashtë kontekstit, të shoqërohen me tituj sensacionalë, ekzagjerime ose me paraqitje vizuale stereotipe, dhe nuk duhet të zbulojnë të dhënat personale që mund ta rrezikojnë sigurinë dhe dinjitetin e bashkëbiseduesit/es.

Përmbajtja vizuale

Në epokën e medie digjitale dhe rrjeteve sociale, paraqitjet vizuale janë pjesë e pandashme e raportimit mediatik dhe shpesh janë pikërisht ato që tërheqin vëmendjen e publikut. Në kontekstin e raportimit mbipastrehësinë dhe varfërinë nuk duhet të harrojmë që figurat, fotografitë ose materialet video gjithashtu duhet të përputhen me parimet e dinjitetit, respektit dhe mbrojtjes së sigurisë së personave me të cilët dhe për të cilët flasim.

Fotografitë, materialet video dhe figurat duhet ta ndihmojnë publikun t'i shohë personat në situatë të pastrehësisë si individë të plotë, të identifikohet me problemet e tyre dhe të njohë faktorët sistematikë që kontribuojnë për varfërinë e skajshme, pabarazinë dhe përjashtimin nga strehimi.

Duhet të shmangen paraqitjet stereotipe që e reduktojnë pastrehësinë në imazhe ekstreme, si ato ku në fokus është një person që fle në stol, në rrugë, ose kërkon në kontejnerë mbeturinash, si edhe imazhet e vuajtjes, mjerimit ose ndyrësisë.

Nuk është e pranueshme fotografimi ose xhirimi pa pëlqim, xhirimi sekret, as fotografimi i personave në situata të rrezikshme dhe intime që cenojnë dinjitetin e tyre. Nuk duhet të publikohen fotografitë ose xhirimet që mund të përdoren si prova kundër personit për të cilin raportojmë (xhirimet e fëmijëve që lypin ose punojnë në rrugë, të personave që përdorin substanca të paligjshme, sidomos jo nëse prej tyre mund të zbulohet identiteti i personit) ose që mund të shërbejnë për ta lokalizuar, dënuar ose dëmtuar atë.

Rekomandohet përdorimi i materialeve vizuale që ofrojnë një kontekst më të gjerë dhe paraqesin shumëllojshmërinë e situatave jetësore – shoqërimin, mbështetjen e ndërsjellë, hobet, si edhe figurat dhe fotografitë që, në një mënyrë të tërthortë ose alegorike, paraqesin problemet sistematike: “labirinte” institucionale dhe procedura “të ndërthurura”, dyer të kyçura, pozita të pabarabarta nisjeje etj.



fotografi: Marija Janković



**ROLI I
MEDIEVE**

**ROLI I
MEDIEVE**

**ROLI I
MEDIEVE**

Qëllimi i raportimit etik mbi pastrehësinë dhe varfërinë është ngritja e ndërgjegjësimit të publikut se e drejta për strehim dhe për një jetë me dinjitet janë çështje që i përkasin tërë shoqërisë, dhe se politikat e drejta të strehimit, mbrojtja sociale dhe mbështetja institucionale duhet të jenë të qasshme për të gjithë qytetarët dhe qytetaret.

Pastrehësia dhe varfëria nuk janë tragjedi personale, fate të vështira dhe histori tronditëse jetësore, por simptoma të një sistemi që ka dështuar dhe në të cilin të gjithë jemi në rrezik.

Mediet mund të kontribuojnë për një kuptim më të mirë dhe për rritjen e solidaritetit nëse raportojnë për shkaqet sistematike, politikat publike dhe efektet e tyre, për shërbimet e disponueshme të mbështetjes, shembujt e praktikave të mira, përvojat e njerëzve që kanë dalë nga situata e pastrehësisë dhe sfidat e tyre të përditshme, dhe jo vetëm për situatat e krizës.



Rrjeti për Luftën kundër Pastrehësisë

mreza.beskucnistvo@gmail.com

A11 – Nisma për të Drejtat Ekonomike dhe Sociale

www.a11initiative.org
office@a11initiative.org

+381 11 3225 172
+381 11 3232 030
+381 60 1772 454

Raporte: <http://www.a11initiative.org/publikacije/izvestaji/>

ADRA Serbi

www.adra.org.rs
office@adra.org.rs

+381 11 4087 802
+381 60 8080 561 (pastrehësia, donacionet)
+381 11 3442 625 (faks)

Publikime: - <http://adra.org.rs/publikacije-adra/>

KlikAktiv – Qendra për Zhvillimin e Politikave Sociale

www.klikaktiv.org
info@klikaktiv.org
+381 64 6599 177

Liceulice

www.liceulice.org
vendors@liceulice.org
redakcija@liceulice.org
info@liceulice.org

+381 11 2686 567

Qendra Rinore CK13 / Kuzhina e Solidaritetit NS

www.ck13.space
office@ck13.space
pr@ck13.space
kuhinasolidarnostins@gmail.com

+381 21 4737 601

PIN – Rrjeti i Inovacioneve Psikosociale

www.pin.org.rs
office@pin.org.rs

+381 62 8880 927

Caritas Serbi

www.caritas.rs
zastita@caritas.rs
secretariat@caritas.rs

+381 11 4099 561

Kuzhina Solidare

www.solidarnakuhinja.org
solidarna.kuhinja@gmail.com

+381 63 1455 930

Info park

gordan@infopark.online

+381604050248

Patrija / Novi Sadi

www.patrija.com
ngopatria@gmail.com

+38163549365

Organizata Humanitare Ekumenike (OHE) / Novi Sadi

office@ehons.org

+381 21 466 588

Grupi BUDI 1 / Novi Sadi

groupb1.org
office@groupb1.org

+381600561759

Astra

www.astra.rs
astra@astra.rs

+ 381 11 785 0001

Izlazak

info@izlazak.org

+381 61 255 27 37